

GRUPIMI “EL-AHBASH” POLEMIZOJNË PA DITURI DHE SILLEN PA EDUKATË

HYRJE

Që para disa vitesh, kam dëgjuar për një grupim i cili është paraqitur në Liban, dhe anëtarët e tij i kanë shqetësuar muslimanët duke lansuar në mesin e tyre qëndrime të disa individëve, të cilat qëndrime trajtohen si përjashtim e jo qëndrime të dijetarëve me peshë. Poashtu, ata janë paraqitur edhe me orientime të devijuara si dhe me mendime të rrezikshme në fushën e besimit-akaidit, të drejtës islame-fikhut dhe sjelljes. Kjo dhe ata kanë shkuar aq larg në këtë drejtim, sa që e kanë liruar nga zekati pasanikun i cili posedon pasuri të shumtë në monedha letre të cilat përdoren në kohën tonë, si dhe e kanë lejuar kamatën në këto monedha, me pretekst se këto monedha nuk janë monedha legjitime nga aspekti i shariatit, gjegjësisht nuk janë ar dhe argjend. Poashtu, ata ia kanë lejuar muslimanit që mos ta falë namazin e xhumasë nëse ka ngrënë qepë, apo nëse të njejtën e ka futur në xhep. Ata e kanë lejuar përzierjen mes meshkujve dhe femrave pa kufij dhe kushte.

Mirëpo, pas gjithë kësaj, më e rrezikshmja është se ata e konsiderojnë kafir-jobesimtar, çdo një musliman që nuk pajtohet me ta, qoftë nga hadithologët apo nga dijetarët e hershëm. Kështu, ata e kanë cilësuar si jobesimtar shejhu-l-islam Ibn Tejmijen dhe nxënësin e tij ibn Kajjimin, si dhe dijetarët tjerë të cilët e kanë ndjekur rrugën e tyre, fjala vjen si reformatori i Gadishullit Arabik shejh Muhamed ibn Abdu-l-Vehab. Ata kanë cilësuar si jobesimtarë edhe shumë dijetarë të kohës më të re, si: dijetarin e madh, shejh Abdu-l-Aziz ibn Baz, mendimtarin islam Sejjid Kutub, etj. Në librin tim “Es-Sahve el-islamijje bejne-l-xhuhudi ve et-tetarruf”, kam përmendur se rrëshqitja në humnerën e cilësimit të muslimanëve si mosbesimtarë-et-tekfir, është prej argument më i rrezikshëm i ekstremizmit dhe teprimit e tejkalimit të kufijve në fenë e Allahut.

Këta teprues të devijuar, pretendojnë se janë pasues të imam Ebu-l-Hasen el-Esh’arijut në çështjet e besimit, si dhe imam Shafiut në çështjet e fikhut, ndërkaq pretendojnë se janë pasues të tarikatit sufist Rifajj. Realisht, ata janë më së largu nga metodologjitë e të tre personaliteteve: në besim, fikh dhe sjellje.

Ky grupim i cili së pari është paraqitur në Liban, dhe që njerëzit e quajtën me emrin “El-Ahbash”, nisur nga ajo se ai që ishte bartës i thirrjes së tyre erdhi prej Etiopie-Habeshe, gjegjësisht prej Hereri¹. Ky person thirri në këtë thirrje të re, e cila ka preokupim kryesor të vetin ndarjen e

¹ Abdullah ibn Muhamed esh-Shejbij el-Abderij, i cili është quajtur el-Hereri sipas regjionit Herer në Etiopi. Ky person ka lindur në Herer, në fisin esh-Shejbanij, i cili i përket fisit arab Beni Shejbe. E mësoi gjuhën arabe dhe fikhun shafi’it në fshatrat shkretinor të këtij regjioni. Në fillim, është besatuar se do ta ndjek tarikatit Tixhanij, por pas një kohe, kaloi në tarikatit Rifajj dhe u morr me shkencën e hadithit. Ai u njoh si njeri që polemizon, kundërshton dhe që mban qëndrime përjashtuese, që kur ishte në Herer, si dhe bashkëpunoi me dhëndrin e diktatorit Hilasilasi, kundër shoqatave për memorizimin e Kur’anit që vepronin atje në vitin 1940. Kjo aferë u njoh si fitneja e vendeve të Kulubit, dhe në këtë aferë pësoi një veprimtar musliman i cili vuajti burg 23 vjet. Atëbotë, njerëzit e quajtën këtë njeri “shpifës” apo “shejhu i fitnes”, dhe si rezultat i kësaj, shumë veprimtarë të devotshëm ikën në Egjipt dhe Saudi. Ky person emigroi nga vendi i tij dhe shkoi në Siri. Atje qëndroi një kohë, dhe askush nuk ia vari veshin, dhe asnjë nuk shkoi të mësojë tek ai. Pastaj shkoi në Liban, në kohën kur në Liban kishte luftë qytetare dhe probleme sektare, dhe për shkaqe të ndryshme të brendshme dhe të jashtme, politike dhe fetare, ky shejh bëri pasues dhe simpatizantë. Forcat e ndryshme politike i shfrytëzuan për qëllimet e veta dhe për t’i goditur xhematet tjera islame. Ky peson i sulmoi ashpër ata të cilët i quajti “Vehabistë”, i cilësoi si jobesimtarë shejhu-l-Islam Ibn Tejmijen, Imam Ibn Kajjimin, Ibn Abdu-l-Vehabin, Ibn Bazin, Sejjid Kutubin, Meududin dhe dijetarë e misionarë tjerë islam. Ata kanë fetvaja që konsiderohen përjashtim nga të zakonshmet, kanë mendime të rrezikshme dhe sjellje shumë të keqe. Preokupimi i tyre më i madh është përçarja e muslimanëve, nxitja e fitneve mes tyre, Allahu na ruajtë. Krahas gjithë kësaj, shejhu nga Hereri,

unitetit të bashkësisë muslimane, shqetësimin e veprimtarëve dhe ndezjen e zjarrit të fitnes në rathët e muslimanëve, si dhe të pengojë çdo veprimtari konstruktive për ta ndihmuar Fenë Islame.

Unë kërkoj falje prej vëllezërve tanë të dalluar dhe të zellshëm të Etiopisë, si dhe prej zotëriut të Etiopisë, Bilalit r.a., ngase ky grupim e kanë njollosur emrin e Etiopisë dhe etiopianëve të vërtetë, sepse këta nuk kanë kurgjë të përbashkët me etiopianët e ndershëm, ndërkaq etiopianët e ndershëm janë të pastër nga mëkatet e këtij grupimi, i cili e ka marrur emrin e tyre pa të drejtë, sikur që ka qenë ujku i pastër nga gjaku i birit të Jakubit a.s. Ky grupim janë njerëzit më të largët nga kultura dhe morali i Bilalit r.a.

Në fillim, nuk jepja mendim për këtë grupim, dhe nuk besoja në gjërat të cilat i dëgjoja për ta. Nuk fola dhe nuk shkruajta asgjë për ta, nuk i preka me asnjë fjalë, ngase ende i kisha gjërat jo të qarta për ta. Por, pasi e kuptova të vërtetën për ta, dhe idetë e thirrja e tyre u bë e njohur në vende të ndryshme, nuk munda të mos flas. Në disa libra të mia të fundit, fort pak i kam prekur dhe kam dhënë për ta kritika të lehta. Në disa konferenca, u jam përgjigjur atyre të cilët më kanë pyetur për disa mendime të tyre që konsiderohen përjashtim, siç është rasti me lejimin e konsumimit të cigares, lejimin e përzierjes së meshkujve dhe femrave pa kushte, etj. Me këtë rast, i kam sqaruar gabimet e tyre në këto çështje, por, pa i akuzuar ata se janë jobesimtar apo mëkatarë, ngase kjo nuk është natyra ime.

Mirëpo, si duket, këto kritika të mia të lehta, i kanë goditur ata për vdekje, ashtu që shpërthyen me vrull dhe u lëshuan si të tërbuar që ta pengojnë programin televiziv botëror islam “Esh-Sheriatu ve-l-hajat” në kanalin satelitor Al-Jazeera në Katar. Ata i lëshuan nga çdo anë shigjetat e sulmit drejt këtij programi dhe ligjëruesit në këtë emision. Por, kur këta zhurmberës nuk arritën tjetër gjë pos uljes së kokës, i dërguan një letër drejtorit të kanalit Al-Jazeera, ku i kërkonin që të zhvillojnë një duel me mua në këtë medium. Unë sikur të kisha pranuar diçka të këtillë, do t’i drejtoja te disa nxënës të nxënësve të mi, që me ata të dalin në duel, mirëpo ata janë shumë të vegjël që të zhvillohet me ta duel, ngase ata nuk kanë ndonji peshë shkencore që do t’ua lejonte futjen e tyre në duele, bile edhe me nxënësit më të vegjël.

Disa vëllezër të nderuar nga elita e dijes, e kishin lexuar letrën që disa nga ky grupim ia kishin dërguar kanalit televiziv Al-Jazeera ku kërkonin duel televiziv me mua, dhe e kishin parë se ata në atë letër e kishin derdhur gjithë mllefin e tyre kundër meje, sa që kishin pretenduar se unë i kam tejkualuar kufijtë e sheriatit, Allahu na ruajt. Këta vëllezër mu lutën që t’i demantoj këto pretendime të tyre të shënuara në letrën në fjalë, marrë parasyshtë se kjo letër paraqet tezat dhe pretendimet e tyre më të rëndësishme. Nëse ua demantoj këto pretendime, me këtë u demantohen atyre të gjitha pretendimet, dhe nuk do t’u ngelet diçka ku të kapen.

Unë, duke e nisur nga dëshira e këtyre vëllezërve të dashur, pranova që t’i shkruaj këto rreshta me qëllim që të zbardhet e vërteta dhe të mposhtet e pavërteta, edhe pse kriminelët nuk duan. Unë këtë e bëj përkundër vullnetit tim, ndërkaq ata vetë e kanë marrë në qafë vetveten dhe e kanë ndezur këtë betejë të ashpër, por zjarri i saj do t’i djeg vetë ata, me ndihmën e Allahut. Allahu i Madhërishtëm ka thënë: <<...**por dredhia e keqe nuk godit tjetër vetëm ata që e kurdisën...**>>²; <<**O ju njerëz! Kryeneçësia juaj është vetëm kundër vetes suaj...**>>³. Prej ligjeve të Allahut është se ai që bën kurtha, bie vetë në ato kurtha. Unë do t’i luftoj vetë këta zhurmberës, me ndihmën e Allahut, pastaj me lapsin dhe gjuhën time, do t’i zbuloj fshehtësitë e tyre, do ta heq perden nga kamuflazhat e tyre, ngase të keqen e keqja e ndal, e ai që e fillon është më zullumqar. Një poet ka thënë: Kur tjerët më luftonin, edhe unë i luftoja, po a thua unë për këtë, o Hemedan, jam tiran?

Unë, do të futem në këtë betejë, me lapsin tim, të cilin e kam përkushtuar të jetë në shërbim të së vërtetës gjatë gjithë jetës sime, dhe kështu do të ngelet deri në vdekje, me lejen e

tërhoqi shumë pasues, të cilët belbëzojnë gjëra të cilat nuk i njohin. Shih librin *El-Harekatu-l-batinijje ve-l-munavie li-l-Islam*, kapitulli El-Ahbash, f.430 dhe më pas. Botues:en-Nedvetu-l-alemijje lish-shebabi-l-islami.

² Fatir: 43.

³ Junus: 23.

Allahut:<<Thujaj:’Namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për Allahun, Zotin e botëve!(162) Ai nuk ka shok...>>.4

BETEJË QË MË ËSHTË IMONUAR

Betohem në Allahun, nuk kam dashur të futem në këtë betejë, dhe kësaj beteje i futem përkundër vullnetit tim, për dy shkaqe kryesore:

I pari:Unë jam i preokupuar me forcat antiislame të cilat duan që t’i shkulin rrënjët e këtij umeti, siç janë:sionizmi botëror, kryqëzatat perëndimore, politeizmi lindor, filozofitë ateiste dhe nihiliste, grupimet laike, drejtimet anarkiste, si dhe të gjitha forcat tjera destruktive dhe famëkeqe, të cilat i rrinë në pritë umetit islam. Për këtë, vërtet, unë nuk kam kohë tepër që të harxhoj kundër ndonjë pale muslimane, edhe nëse kanë lajthitur dhe i kanë tejkaluar kufijtë.

I dyti:Islami më ka mësuar që të nderozi kandila, e mos ta mallkojë terrin, ta sqarojë të vërtetën, e jo ta shajë të pavërtetën. Allahu i Madhërishtëm ka thënë:<<**Ju mos ua shani ata (zota) që u luten (idhujtarët), pos Allahut, e (si hakmarrje) të fyejnë Allahun nga armiqësia, duke mos ditur (për madhërinë e Tij)...>>.5**

Gjatë gjithë jetës sime, unë jam munduar të ndërtoj e mos të shkatërroj, të bashkoj e mos të përçajë, që çdo njërin ta lë të lirë të zgjedh vetë çka don për vete, e mos t’i detyrojë njerëzit ta marrin mendimin tim, po as që kam lejuar tjerët të më detyrojnë ta marrë mendimin e tyre. Nëse Allahu i Madhërishtëm e ka urdhëruar të Dërguarin e Tij të fundit që t’u thotë jobesimtarëve:<<**Ju keni fenë tuaj, e unë kam fenë time**>>6, pse unë mos u them vëllezërve të mi muslimanë:Ju keni mendimin tuaj, e unë e kam mendimin tim, ju i keni punët tuaja, e unë i kam punët e mia?

Mirëpo, ky grupim për të cilin po flas, refuzuan që unë të kemë mendimet dhe qëndrimet e mia, ndërkaq dijetari musliman nuk i afrohet Allahut, pos se me atë që ka konstatuar me ixhtihadin e vet, pa marrë parasyshë ia ka qëlluar apo nuk ia ka qëlluar. Nëse ia ka qëlluar, dijetari shpërblehet me dy shpërblime, e nëse nuk ia ka qëlluar, shpërblehet me një shpërblim. Kjo është prej mrekullive të kësaj feje:Njeriu shpërblehet edhe nëse nuk ia qëllon, nëse kjo ka ardhur pas një analize dhe ixhtihadi të njerëzve kompetentë në vendin e vet.

Është për tu çuditur se si ata njerëz ia kanë përkushtuar veten ndërhyrjes në emisionet e mia televizive që të plasojnë gënjeshtër dhe shpifje të pabaza, siç ndodhi rasti në emisionin “esh-Sheriatu ve-l-hajat” në kanalën Al-Jazeera, si dhe në emisionin “Shuabu-l-iman” në kanalën satelitor të Katarit. Unë, ndaj sjelljes së tyre arrogante, në herën e parë, u solla me butësi, maturi dhe injorim, nuk reagoja, por shujta, ashtu siç ka thënë Allahu i Madhërishtëm:<<**Dhe kur e dëgjojnë ndonjë llomotitje marrëzie, i kthejnë shpinën dhe thonë:’Ne kemi veprat tona e ju tuajat, qofshi larg nesh, ne nuk na duhen injorantët!’>>.7 Mirëpo, kjo sjellje e butë nga ana ime, u dha shtytje që të vazhdojnë me arrogancën e tyre, ashtu që arroganca e tyre u shtua edhe më tepër, ngase butësinë time e kujtuan dobësi. Pasha Allahun, ajo nuk qe dobësi, por unë nuk desha që të humb kohë dhe mund duke e nderur zjarrin e përçarjes mes muslimanëve, kur ata janë më se të nevojshëm për bashkim dhe unitet. Por, kjo sjellje e pahijshme dhe arrogante, dhe këto sulme me gjëra të pabaza, më bënë që unë ta mar lapsin dhe t’i demantojë tezat e tyre, me qëllim që ta shohin se sa peshojnë dhe të ngelin në vrimat e tyre. Siç thash edhe më parë, këtë e bëj përkundër vullnetit tim, por ashtu siç i tha Allahu i Madhërishtëm të Dërguarit të Tij dhe shokëve të të Dërguarit:<<**Ju e është bërë obligim lufta, ndonëse ju e urreni atë. Por mund që ju ta urreni një send, e ai është shumë i dobishëm për ju, dhe mund që ju ta doni një send, e ai është dëm për ju. Allahu e di (fundin e çdo sendi) e ju nuk dini (216)>>.8****

4 El-En’am: 162-163.

5 El-En’am: 108.

6 El-Kafirun: 6.

7 El-Kasas: 55.

8 El-Bekare: 216.

Është për tu çuditur, ngase Ahbashët më akuzojnë se jam vehabist, fanatik pas dijetarëve vehabist, ngase gati nuk zë në gojë tjerë pos Ibn Tejmijes, ibn Kajjimit dhe shkollës së tyre. Ata, këta dy dijetarë, i akuzojnë se e kanë kundërshtuar konsensusin-ixhmanë në disa çështje fetare. Nga ana tjetër, vëllezërit vehabist apo selefistë, shpërndajnë në Xhide, Rijad dhe në qytetet tjera të Saudisë, shpërndajnë pamflete ku më sulmojnë. Unë nuk i kënaqi as këta, as ata tjerët, e të dy palët e demantojnë njëra-tjetrën. Unë nuk jam rob i askujt tjetër pos Allahut Nji dhe të vetëm, dhe nuk jam peng i askujt, por se i Kur'anit dhe Sunetit. Unë i dua të gjithë dijetarët e dëshmuar të umetit, i vlerësoj lartë ata, por unë nuk i shejt[roj dhe nuk pretendoj se ata janë të pagabueshëm.

Dua që të konfirmoj se ky sulm i orkestruar nga të dy palët, nuk do të zbrapsin nga qëllimi për të cilin e kam zotuar veten, e kam dhuruar jetën, dhe e kam mobilizuar mendimin, gjuhën dhe lapsin tim, gjegjësisht thirrja në mesatarinë e Islamit, si dhe nuk do të heq dorë nga metodologjia ime e cila konsiston në të qenit jo tolerant në baza, dhe i lehtë në çështjet periferike, e ndërtuar mbi lehtësimin në fetva dhe përgëzimin në thirrje. Falë Allahut, mua më janë përgjigjur pjesa dërmuese e muslimanëve, në veçanti intelektualët në anë të ndryshme të botës. Për këtë, qoftë falënderuar dhe lavdëruar Allahu i Madhërishëm.

Ata më kërkuan duel, dhe ishin mjaftë këmbëngulës në këtë kërkesë. Por, unë kërkesën e tyre e hudha pas shpine, ngase jo çdo njërit që kërkon diçka, bile edhe pa të drejtë, i pranohet kërkesa. Unë nuk do t'u jap rast që ta zhvillojnë këtë duel televiziv, për disa shkaqe:

1. Ata duan që në llogarinë time, të ekspozohen në ekranet e kanaleve satelitore. Unë nuk do t'ua mundësojë këtë rast, por u them "vdisni me mllefin tuaj".
2. Ata duan t'u thonë atyre palëve të dyshimta për të cilët punojnë:"Ja, ne patëm duel me Kardavin".
3. Pjesa më e madhe e asaj për të cilën duan duel, sipas asaj që kam dëgjuar prej vetë atyre, ka të bëjë me disa çështje të cilat i kam shpjeguar në librat e mia. Këto gjëra nuk zgjidhen me duele, por libri demantohet me libër si ai, nëse mund ta bëjnë këtë.
4. Dule nënkupton që të dy palët të jenë të një kalibri, ndërkaq ata nuk janë të kalibrit tim, as në moshë dhe as në trashigiminë shkencore. Nëse ndonji nga ata ka 74 vjet, ka më tepër se 100 libra, shumë nga të cilat kanë pësuar nga dhjetra botime, dhe pjesa më e madhe e të cilave është përkthyer në gjuhë që i flasin popujt muslimanë dhe gjuhë botërore në përgjithësi, mund të pranoj të dal në duel, nëse e shoh këtë të dobishme. Nisur nga kjo, unë, nëse dua, mund që duelin me ata t'ua lë nxënësve të mi më të vegjël, e ai me ndihmën e Allahut, ka mundësi t'i mposht me një të goditur.
5. Unë e kam provuar metodën e dueleve, por kam parë se nuk është produktive. Kam bërë duel me laikët, dhe kemi ngadhnjyer mbi ta falë Allahut, por, edhe pas kësaj, ata nuk kanë lëvizur nga qëndrimet e veta as sa një qime floke.
6. Unë do të zhvilloj dule me ta, në një mënyrë tjetër, gjegjësisht do të zhvilloj dule me ta me laps e jo gojarisht. Së këtejmi, i shkruajta këto fletë që t'i nxjerri në shesh kontradiktat, devijimet dhe injorancën e tyre të madhe, si dhe të sqarojë se sa kontradiktorë që janë, dhe sa gënjeshtër që lansojn. Unë nuk them më tepër se ajo që e ka thënë pejgamberi i Allahut, Shuajbi:<<...**unë nuk dua tjetër vetëm të përmirësoj aq sa mundem, por këtë mund ta arrijë vetëm me ndihmën e Allahut, vetëm Atij iu kam mbështetur dhe vetëm tek Ai jam i drejtuar!**>>.⁹

⁹ Hudë: 88.

PËRMBAJTJA E LETRËS SË AHBASHËVE DREJTUAR KANALIT AL-JAZEERA

Para se t'i demantoj të pavërtetat e grupimit El-Ahbash, do ta prezantoj letrën të cilën ky grupim ia dërguan me faks drejtorit të kanalit Al-Jazeera. Kjo letër mbante vulën e "Shoqata e projekteve bamirëse islame", ndërkaq ishte e nënshkruar nga Usame es-Sejjid. Në vazhdim e keni tekstin e letrës së grupimit El-Ahbash:

I nderuari drejtor i përgjithshëm i kanalit Al-Jazeera, Muhamed Xhasim el-Ali, esselamu alejkum ve rahmetullahi ve berekatuhu.

Unë më parë kontaktova me drejtorin e intervistave Nebil Nexhmudin për një çështje, e ai më drejtoi te ju.

Ne kërkojmë që në kanal tuaj të na mundësoni një duel me Dr.Jusuf el-Kardavin, ngase ky njeri e ka kundërshtuar sheriatin e pastër islam në shumë çështje. Ne, me qëllim që ta zbardhim të vërtetën dhe ta mposhtim të pavërtetën, dhe nisur nga ajo se e dimë se ju mundoheni t'i paraqisni mendimet e ndryshme, kërkuam nga ju që të na mundësoni këtë duel. Me këtë rast, do t'ua përmendi disa pika të cilat do të trajtohen në këtë duel:

1. Ky njeri, i lavdëron ekstremët dhe thotë:"Ky është teprim, i cili i ka shtyrë ata të rinjë të devotshëm xheloz për fenë, që t'i cilësojnë jobesimtarë ata muslimanë të cilët nuk pajtohen me mendimet e tyre, dhe ta konsiderojnë të lejuar gjakun dhe pasurinë e tyre". Ndërkaq, në një vend tjetër thotë:"Së këtejmi, unë qëndroj fortë në qëndrimin se ata djelmosha janë vëllezërit tanë, edhe përskaaj asaj se e kanë tepruar dhe kanë lajthitur nga rruga e qëlluar.
2. E kemi vërtetuar se ai është një nga themeluesit dhe aksionerët e të ashtuquajturës "Bank Al-Takva" në ishujt e Bahameve, ku bashkë me të janë edhe shumë përgjegjës të mëdhej të partisë "El-Ihvan el-muslimun" nëpër botë. Është e ditur se kjo banlë zhvillon veprimtari shumë të dyshimta.
3. Ky njeri i lavdëron figurat ekstreme, si Sejjid Kutubi, Ebu-l-A'ëla el-Meududi. Ky e quan Sejjid Kutubin shehid, dhe i këshillon njerëzit që t'i lexojnë librat e tij, ndërkaq ai është koka e ekstremizmit dhe terrorizmit në shekullin njëzet.
4. Ky, në një pyetje që iu parashtrua, u përgjigj se vendimi i një gjykate në Gjermani, për ndarjen e gruas nga burri musliman, është valid. Kjo fetva është e pabazë me konsensus-ixhma.
5. Në një rast tjetër, ka pretenduar se e haku i mësuesit ndaj nxënësit, është më i madh se haku i prindërve të atij nxënësi. Edhe ky konstatim është i pa bazë.
6. Në librat e veta, e lavdëron Nasirudin Albanin dhe e quan muhadith të madh, ndërkaq Albani është i devijuari më i madh në këtë kohë, i cili ka mendime që i kundërshton gjithë tjerët. Albani ka kërkuar prej shtetit saudian që ta nxjerr varrin e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. dhe dy shokëve të tij, prej xhamisë së Pejgamberit s.a.v.s. Ai ka dhënë fetva se banorët e Bregut Perëndimor në Palestinë, janë jobesimtarë dhe mëkatarë, ngase nuk janë larguar prej aty, sikur që është larguar i Dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe sahabet prej Meke në Medine.
7. Ky njeri, mendon se pula e ngulfatur lejohet të hahet, gjë që bie ndesh qartë me ajetin fisnik.
8. Ky njeri thotë:"Nji dirhem i kamatës, të cilin njeriu e han me vetëdije, është më i keq se 36 kurvëri". Këto fjalë janë në kundërshtim me argumentet

tradicionale, racionale dhe me konsensusin, edhe pse ai është mbështetur në një hadith jo të saktë, ndërkaq i njëjti vetë është besatuar se do të merr për argumente vetëm hadithe të sakta.

Në fund, këtë që e themi, si dhe qindra çështje tjera, e kemi vërtetuar nga librat e tij, nga revistat e ndryshme, dhe nga burime tjera.

Për atë, shpresojmë që ju i nderuar, do të mundësoni hapësirë për duel mes palës së parës Kardavit, dhe palës së dytë, shejh Usame es-Sejjid, kryetar i degës së Bikait në Shoqatën e Projekteve Bamirëse Islame, njëherit edhe kryetar i zyrës për informim të kësaj shoqate, si dhe drejtorit të degës së Veriut në këtë shoqatë, shejh Ganim Xhelul.

DEMANTIMI I DYSHIMEVE TË AHBASHËVE

Kjo ishte letra e tyre ku i paraqitën vërejtjet e tyre më të rëndësishme. Unë do ta detyrojë veten t'i demantoj këto dyshime në vazhdim, duke kërkuar ndihmën e Allahut të Madhërishëm.

PRETENDIMI I LAVDËRIMIT TË EKSTREMËVE

Pjestari i grupimit El-Ahbash, duke i sqaruar çështjet në të cilat unë e kam kundërshtuar sheriatin e pastër, dhe për të cilat çështje ai kërkon dule me mua, Allahu e udhëzoftë, ka thënë: "Ky i lavdëron ekstremët dhe thotë: Ky është teprim, i cili i ka shtyrë ata të rinjë të devotshëm xheloz për fenë, që t'i cilësojnë jobesimtarë ata muslimanë të cilët nuk pajtohen me mendimet e tyre, dhe ta konsiderojnë të lejuar gjakun dhe pasurinë e tyre". Ndërkaq, në një vend tjetër thotë: "Së këtejmi, unë qëndroj fortë në qëndrimin se ata djelmosha janë vëllezërit tanë, edhe përsëri asaj se e kanë tepruar dhe kanë lajthitur nga rruga e qëlluar".

Pra, kjo është çështja e parë e rrezikshme, për të cilën ky pjestar i ngratë i grupimit El-Ahbash dhe ahbashët tjerë të cilët qëndrojnë pas tij, mendon se unë e kam kundërshtuar fenë e pastër. Këto fjalë që janë përmendur në letrën e tyre, janë marrur nga traktati im "Dhahiretu-l-guluvvi fi et-tekfir" (Fenomeni i tepimit në cilësimin e tjerëve jobesimtarë), të cilën e pritën dijetarët dhe thirrësit islamë në gjithë botën islame me admirim, patën komplimente ndaj këtij traktati, e përkthyen në shumë gjuhë dhe dhjetëra mijëra kopje u publikuan në serinë "sautu-l-hakk" (Zëri i së vërtetës), të cilën e botonte Komuniteti Islam në Universitetin e Kajros. Nuk e di çka është ajo që e kanë detektuar ata njerëz të cilët janë injorantë të plotë në sheriatin e Allahut, se është në kundërshtim me sheriatin e pastër. Mirëpo, problemi i tyre është se injoranca e tyre është e thellë, nuk është e thjeshtë. Ata janë injorantë, dhe muk e dinë se janë injorantë.

Ata njerëz nuk kanë asnjë sens në rrugën e thirrjes islame, nuk kanë asnjë sens edukativ dhe asnjë sens prindëror në kurimin e fenomenit të dhunës, e cila kërkon të trajtohet me butësi dhe urtësi. Një fjalë e urtë arabe thotë: "Hunda jote është pjesë e jotja, edhe nëse është e prerë". Ata njerëz të cilët e teprojnë, pjesa dërmuese e të cilëve janë të rinj, janë prej nesh, edhe nëse kanë devijuar dhe janë larguar nga rruga e drejtë. Për atë, patjetër t'i trajtojmë me butësi, ashtu si e trajton mjeku pacientin.

Pastaj, çka mund të merret si vërejtje ndaj meje kur them se ata të rinj janë vëllezërit tanë, edhe nëse kanë devijuar nga rruga e drejtë. A thua Ahbashët duan që unë t'i cilësoj, këta të rinj, jobesimtarë dhe t'i nxjerri nga feja, ashtu siç veprojnë vetë Ahbashët? Udhëheqësi i besimtarëve, Ali ibn Ebi Talibi r.a., nuk i cilësoi jobesimtarë Havarixhët, edhe pse ata e cilësonin Aliun si jobesimtar, e bënë hallall gjakun e tij, ndërkaq Aliu ishte një ndër figurat më të mëdha të këtij umeti, kalorës i shquar i Islamit. Aliu r.a. nuk i cilësoi ata se janë jobesimtarë, edhe përsëri asaj se për atë grupim në hadith thuhet: "Ata largohen prej feje, sikur që largohet shigjeta prej

harku”.¹⁰ Kur e kanë pyetur për Havarixhët se a janë jobesimtarë? Është përgjigjur:”Ata nga mosbesimi kanë ikur”. E kanë pyetur përsëri:”Po a janë munafikë?” Është përgjigjur:”Sikur të kishin qenë munafikë, nuk do ta përmendin Allahun vetëm se pak”. I kanë thënë:”Po atëherë, çka janë?” Ka thënë:”Vëllezërit tanë të djeshëm, na kanë luftuar sot”. Poashtu, ka thënë:”Ai që e kërkon të vërtetën dhe gabon, nuk është si ai që e këkon të pavërtetën dhe e arrinë”.

Ne duhet t’i trajtojmë ata të rinj që e kanë tepruar, me këtë shpirt prindëror, dhe kjo është shkak pse unë kam thënë për ta:”Ata janë njerëz të devotshëm, xheloz për fenë e tyre, dhe ata janë vëllezërit tanë, edhe nëse kanë devijuar dhe i kanë tejkaluar kufijtë”.

Kjo më shtyri mua që të mendoj seriozisht për të shkruar një libër për çështjen e tekfirit-cilësimit të muslimanëve jobesimtarë, marrë parasyshë rrezikun dhe pasojat afatgjata të këtij fenomeni. Mirëpo, nuk arrita që ta plotësoj këtë libër. Unë e shkruajta punimin të cilin e publikoi revista “El-Muslim el-muasir” në numrin e nëntë, në Janar të vitit 1977, gjegjësisht dy muaj para se kjo çështje të merr përmasa alarmante dhe të arrijë deri në kidnapimin dhe vrasjen e shejh Dhebebijut, Allahu e mëshiroftë. Në hyrjen e këtij punimi e sqarova rrezikun e fenomenit të cilësimit të muslimanëve jobesimtarë, shkaqet e përgjithshme të cilat kanë shkaktuar paraqitjen e këtij fenomeni, mënyrën si të trajtohet ky problem, si dhe shtrova disa rregulla apo të vërteta fetare, të cilët duhet të jenë pikë referuese. Këto janë rregulla të vërtetuara me argumente adekuate nga Kur’ani dhe Suneti, me shpresë se këto rregulla do të jenë bindëse për ata të cilët e kërkojnë të vërtetën dhe nuk janë verbuar nga fanatizmi ndaj ndonji mendimi. Me këtë gjë, nuk desha tjetër, pos që t’i shërbejë Islamit si dhe mos t’i lë bijtë e sinqertë të Islamit ta humbin rrugën apo t’i pushtojë teprimi. I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ia ka tërhekur vërejtjen umetit të vet nga teprimi dhe ekstremizmi. Ibn Abasi ka transmetuar se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë:”Ruheni prej teprimit në fe, ngase ata të cilët ishin para jush i shkatërroi teprimi në fe”.¹¹ Ibn Mes’udi ka transmetuar se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë:”Janë shkatërruar ekstremët, janë shkatërruar ekstremët, janë shkatërruar ekstremët”.¹² I Dërguari i Allahut s.a.v.s. nuk e përsërit një fjalë, përpos se kur ka rëndësi të madhe, është serioze dhe dëshiron ta theksoj përmbajtjen e saj. Në këtë traktat, përkitazi me çështjen në fjalë, kam thënë:”Ky teprim i cili i shtyu këta të rinj të devotshëm të përkushtuar në fe, që t’i cilësojnë jobesimtarë dhe ta bëjnë të lejuar gjakun dhe pasurinë e atyre muslimanëve të cilët nuk pajtohen me ta, i njejtë qe shkak që, më herët, edhe havarixhët, të mbajnë qëndrime të këtilla ekstreme, bile edhe më ekstreme se këta, sa që e lejuan vrasjen e Aliut r.a., udhëheqësit të besimtarëve. Ndërkaq, kush ka qenë Aliu r.a., sa afër ka qenë me të Dërguarin e Allahut s.a.v.s., sa herët e ka pranuar Islamin dhe sa ka luftuar në rrugë të Allahut!”

“Havarixhët nuk ishin se nuk bënë vepra të mira në Islam, dhe as se nuk bënë adhurim. Përkundrazi, ata faleshin, agjëronin, lexonin Kur’an shumë, ishin guximtarë në të vërtetën dhe e sakrifikonin veten në rrugë të Allahut, sikur që i ka cilësuar shkëlqyeshëm Ebu Hamza Esh-Shari”.

“Mirëpo, veprat e mira, adhurimi i madh dhe qëllimi i mirë, nuk u bënë dobi, ngase ata shkuan në drejtim jo të drejtë, e kush shkon në drejtim jo të drejtë, udhëtimi i gjatë vetëm se edhe më tepër do ta largojë nga qëllimi, ai nuk ka bërë kurgjë...”.

Imam Ahmedi ka thënë se hadithi i cili i qorton Havarixhët dhe na tërheq vërejtjen nga ata, është autentik, dhe kjo është vërtetuar në dhjetë mënyra. Disa nga hadithet të cilat u referohen Havarixhëve janë shënuar në dy Sahihet, e në disa prej tyre qëndron:”Ndonjëri nga ju, e konsideron të ulët namazin e vet në krahasim me namazin e tyre, adhurimine vet, në krahasim me adhurimin e tyre, leximin e vet në krahasim me leximin e tyre”. Mirëpo, edhe përsëri kësaj, hadithi i cilëson ata njerëz se “largohen prej feje, sikur që largohet shigjeta prej harku”. Hadithi ka folur edhe për veçorinë e tyre dalluese, gjegjësisht ata “i lënë të qetë idhujtarët, ndërkaq i vrasin pjestarët e Islamit”. Poashtu, hadithi tregon dhe për cektësinë e tyre, naivitetin dhe mos

¹⁰ Hadithin e ka shënuar Ahmedi, vëll.III, f.33.

¹¹ Hadithin e kanë shënuar Nesaiju, nr.3057 dhe Ibn Maxhe, nr.3029.

¹² Hadithin e ka shënuar Muslimi, nr.2670.

thellimin e tyre në kuptimin e Kur'anit, ngase i përshkruan se “e lexojnë Kur'anin, por ai nuk e kalon fytyn e tyre”.¹³

Unë që herët pata deklaruar, e këtë qëndrim e kam edhe tash, se dhuna nuk luftohet me dhunë, por, prej rrugëve dhe hapave më të rëndësishëm të shërimit të kësaj sëmundje është që ne të sillemi ndaj këtyre djelmohave me frymë prindërore dhe të me mëshirë, larg arrogancës, ashpërsisë dhe fyerjes së tyre, apo përbuzjes së tyre. Poashtu, nuk duhet që ne t'u flasim atyre me mendjemadhësi, nga lartë, duke i distancuar nga ata, gjë që hap hendeqe të gjëra dhe të thella mes nesh dhe atyre. Kështu, me këtë sjellje nga ana jonë, ata e humbin besimin në ne dhe nuk na dëgjojnë, e me këtë, edhe ne nuk mund t'i kuptojmë, nuk mund t'i njohim boshllëqet e jetës së tyre dhe realitetin e problemeve të tyre.

Ne, nuk duhet të sillemi ndaj tyre si “prokuror publik” dhe “përfaqësues të akuzës”, që të formojmë përshtypje se i gjithë qëllimi ynë është t'i zbulojmë të metat e tyre, t'i stërzmadhojmë anët e tyre negative, të dyshojmë në qëllimet e tyre, t'i kontestojmë punët e tyre, dhe me këtë, për ta ta parashohim ndëshkimin më të madh. Por, para së gjithash, ne duhet të sillemi ndaj tyre në mënyrë atërore dhe vëllazërore, t'i bëjmë të ndjejnë se ata janë prej nesh, dhe se ne jemi prej tyre, se ata janë të dashurit tanë, shpresa e jetës sonë dhe ardhmja e umetit tonë. Në këtë mënyrë, ne do t'u futemi atyre nga dera e dashurisë dhe mëshirës, e jo nga dera e akuzës dhe mendjemadhësisë.

Ne duhet të kemi ndaj tyre qëndrim mbrojtës, kur atyre u drejtohen shigjetat e sulmit prej para dhe prej mbrapa shpine, prej anës së djathtë dhe të majtë, me të drejtë apo pa të drejtë, me qëllim të mirë apo me qëllim të keq. E nëse ne nuk kemi ndaj tyre qëndrim mbrojtës, për ndonji shkak, atëherë le të kemi ndaj tyre qëndrim të gjykatësit të drejtë, i cili gjykon vetëm me argumente, dhe nuk anon as ka i padituri e as kah paditësi.

Prej të metave tona është ajo se ne, në çështjet shoqërore, nxitojmë me dhënien e gjykimeve, i japim gjykimet e përgjithësuara dhe kategorike, ashtu që të tilla si i japim, nuk pranojnë procedim të mëtutjeshëm dhe kontestim. Ne, ndodh që ta bëjmë këtë, pa mos e dëgjuar mbrojtjen e të paditurit dhe argumentin e palës kundërshtare, gjë që nuk ka kurgjë të përbashkët me drejtësinë.

Shumë njerëz gjykojnë për ata djelmosha prej distance, pa mos u ulur me ta dhe pa mos i njohtuar, pa mos e ditur si mendojnë dhe se ndjehen, si dhe si sillen. Poashtu, shumë njerëz, gjykojnë për të gjithë, në bazë të sjelljeve të një numri të kufizuar prej tyre, edhe pse pakica nuk mund të jetë gjykuese për shumicën. Nisur nga kjo, juristët islamë e kanë miratuar rregullën se “pjesa më e madhe, e ka tretmanin e të tërës, ndërkaq për rastet e rralla, nuk jepet gjykim”.

Disa tjerë, gjykojnë për një person, në bazë të një veprimi që bën, gjë që ai ka mundur ta bën atë veprim në kushte dhe rrethana të caktuara, e veprimi i tillë, mund të ketë interpretim adekuat nga personi që e ka bërë, sa që nëse e dëgjon ai që e ka kundërshtuar, do të hiqte dorë nga kundërshtimi. Sido që të jetë, nuk bën të japim gjykim me vdekje të sjelljes për një person, për shkak të një apo dy veprimeve, por, njeriu vlerësohet në bazë të gjitha veprimeve që bën. Me këtë, ai që të mirat ia randojnë të këqijat, është prej të mirëve. Në këtë mënyrë i trajton Allahu i Madhërishëm robërit e Vet: << **E kujt i peshojnë më rëndë peshojat (veprat e mira), ata jamë të shpëtuarit (102)**>>¹⁴.¹⁵

Së këtejmi, ata Ahabshë, sikur të kishin qenë të drejtë, dhe fjalët të cilat i kam thënë, për ata djelmosha, të cilët i kanë zënë në gojë, t'i venin në vendin e vet në kontekstin e traktatit në fjalë, e mos i nxirrin nga konteksti, do ta kuptonin se këto janë fjalë të sakta, të sinqerta dhe udhëzuese me ndihmën e Allahut të Madhërishëm.

¹³ Dhahiretu-l-guluvvi fi-t-tekfir, f.8-9.

¹⁴ El-Muëminun: 102.

¹⁵ Shih:Kardavi, es-Sahvetu-l-islamijje bejne-l-xhuhudi ve et-tetarruf, f.135-138.

PJESËMARRJA NË BANKËN ET-TAKVA

Pjestari i grupimit El-Ahbash, duke i sqaruar çështjet në të cilat unë e kam kundërshtuar shariatit e pastër, dhe për të cilat çështje ai kërkon dule me mua, Allahu e udhëzofte, ka thënë:” E kemi vërtetuar se ai është një nga themeluesit dhe aksionerët e të ashtuquajturës “Bank Al-Takva” në ishujt e Bahameve. Është e ditur se kjo banlë zhvillon veprimtari shumë të dyshimta!!”

Pra, kjo është çështja e dytë e rrezikshme, për të cilën ky pjestar i ngratë i grupimit El-Ahbash dhe ahbashët tjerë të cilët qëndrojnë pas tij, mendon se unë e kam kundërshtuar fenë e pastër. Vërtet, nuk e di, çfarë kundërshtimi i shariatit është të marrish pjesë në një bankë islame, statuti i së cilës e ndalon kamatën dhe u përmbahet rregullave dhe dispozitave të fesë islame në transaksione. Bile, kjo bankë dallohet me atë se statuti i saj i është prezantuar komisionit të kontrollit fetar pranë kësaj banke, para se i njejtë të publikohet, ashtu që ka bërë korigjime dhe ndryshime të nevojshme, me qëllim që të jetë kompatibil me parimet dhe dispozitat e të drejtës islame.

Normalisht, grupimi i Ahbashëve nuk e shohin të domosdoshme hapjen e bankave islame, ngase ata mbajnë qëndrimin se valutat e sotme të letrës, nuk i nënshtrohen kamatës, ashtu që ata e lejojnë kamatën në valutat e sotme të letrës me fetvatë e tyre devijuese. Poashtu, ata e lejojnë edhe mosdhënien e zekatit për këto valuta, gjë që qartë na bën me dije se nuk duhet të habitemi nëse ata bashkëpunojnë me bankat me kamatë, ndërkaq i mohojnë bankat islame.

Ndërkaq, unë, bashkë me akademitë e njohura të fikhut islam në Egjipt, Meke, Xhedde, Indi e gjetiu, dhe me dijetarët tjerë të umetit, mbajmë qëndrimin se kamatat e bankave janë kamata e ndaluar në Islam. Së këtejmi, bashkë me dijetarët tjerë të umetit, thirrim në domosdoshmërinë e lirimt nga mallkimi i kamatës dhe lufta e shpallur nga Allahu dhe i Dërguari i Tij, si dhe për hapjen e bankave pa kamatë dhe të pastër nga të gjitha transaksionet e ndaluara. Për atë, pse mos e stimuloj bankën Et-Takva, dhe pse mos të participoj në këtë bankë, siç kam participuar edhe në Bankën Islame të Katarit, në Bankën Islame Fejsal, në Egjipt dhe në Bankën Islame Ndërkombëtare për Investim dhe Zhvillim në Kajro? Stimulimi dhe participimi në bankat islame, si dhe bashkëpunimi me to, janë obligim për çdo musliman, në suaza të mundësive të tij.

Ndërkaq, pretendimi i pjestarit të ngratë të grupimit El-Ahbash, se banka Et-Takva ka aktivitete shumë të dyshimta, na e zbulon fytyrën e vërtetë të këtij grupimi dhe palën për të cilën punojnë. Banka Et-Takva, në kohën e fundit, ka qenë cak i sulmeve të ashpra nga palë të cilat punojnë për llogari të sionizmit dhe kryqzatave, të cilat kanë për qëllim që ta njollosin imazhin e kësaj banke, ta kontestojnë veprimtarinë e saj bankare dhe t’i frikësojnë njerëzit mos bashkëpunojnë me këtë bankë. Këto palë kanë akuzuar se kjo banlë e financon terrorizmin dhe terroristët, gjë që është shpifje dhe rrenë e kulluar, ngase kjo banka nuk ka asgjë të përbashkët me veprimtaritë terroriste. Për këtë, e pyes këtë pjestar të grupimit El-Ahbash, i cili shtirret si i ditur dhe që po na fyen: A thua kjo çështje është çështje shkencore, për të cilën duhet debat shkencor dhe dule?!

Sido që të jetë, ky pjestar i grupimit El-Ahbash, si do ta vërtetoj se unë duke participuar në bankën Et-Takva e kam kundërshtuar fenë e pastër?! Me të vërtetë, mos të ta marre mendja, si është e mundur që ata të cilët i mbështesin bankat të cilat punojnë me kamatë, kur dihet se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. e ka mallkuar atë që e ha kamatën, atë që e jep kamatën, atë që e shkruan aktin e kamatës dhe atë që e dëshmon këtë akt, të jenë në përputhje me fenë e pastër, ndërkaq ai që e lufton kamatën me dituri dhe me vepra, me fjalë, me shkrime, me aktivitetin dhe pasurinë e tij, dhe që e ka mbështetur hapjen e bankave islame, të jetë në kundërshtim me fenë e pastër?! Allahu e mëshiroftë poetin El-Behterij i cili ka thënë:

Më thuaj, si të kërkoj falje, kur mirësitë e mia janë parë si mëkate të mia?!

LAVDËRIMI I SEJJID KUTUBIT DHE MEUDUDIT

Pjestari i grupimit El-Ahbash ka thënë: "Ky njeri i lavdëron figurat ekstreme, si Sejjid Kutubi, Ebu-l-A'ëla el-Meududi. Ky e quan Sejjid Kutubin shehid, dhe i këshillon njerëzit që t'i lexojnë librat e tij, ndërkaq ai është koka e ekstremizmit dhe terrorizmit në shekullin njëzet."

Këtij të tërbuari, i them: Kur'ani na ka mësuar që të flasim drejtë dhe të dëshmojmë drejtë. Allahu i Madhërishëm, në dhjetë porositë në suren El-En'am, ka thënë: <<**Kur të flitni (të dëshmoni), duhet të jeni të drejtë edhe nëse është çështje për (kundër) të afërmit...>>. ¹⁶**

Unë, nuk e kam thënë për Sejjid Kutubin dhe Meududin, pos asaj që e besoj se është e drejtë. Të dy këto figura, kanë qenë thirrës në rrugë të Allahut dhe thirrës të cilët kanë thirrur në kthimin e njerëzve në Islam dhe reformimin e jetës së tyre konform Islamit, në shekullin e katëmbëdhjetë të hixhretit. Të dy kanë dalur kundër materializmit ateist injorant-xhahil, kundër anarkisë nihiliste xhahile, kundër shekullarizmit laik xhahil, si dhe xhahilijeteve të ndryshme të cilat i sulmuan mendjet e muslimanëve duke formuar në to botëkuptime të huaja të importuara. Ata i luftuan këto botëkuptime të gabuara xhahile me aftësitë që ua kishte falur Allahu, me lapsat dhe gjuhët e tyre, me thirrje dhe edukim, si dhe me mobilizim dhe unitet. Të dy këta burra jetuan për Islam dhe vdiqën në Islam. Sejjid Kutubi e ofroi kokën e vet kurban për thirrjen islame si dhe me jetë e paguajti këmbëngultësinë e tij në besim. Fjalët e tij janë bërë realitet: "Fjalët tona do të mbeten si kukulla për lojë, pa ndjenja dhe pa jetë. Kjo do të vazhdojë derisa të vdesim në rrugën e tyre. Atëherë, do marrin shpirtë dhe do të kenë jetë!"

Meududi e ngriti zërin kundër pretenduesve të rrejshëm të pejgamberisë së re-Kadijanizmit, dhe për këtë gjë u gjykua dhe u dënua me vdekje. E ngriti zërin kundër kundërshtarëve të sunetit të cilët pandehnin se janë përkrahës të Kur'anit, dhe i mposhti me argumente. E ngriti zërin kundër thirrësve në vesterizim dhe të huajsim, të cilët donin ta zhveshin umetin nga besimi, sheriati, vlerat dhe trashigimia e vet, e në vend të tyre, t'ia imponojnë civilizimin perëndimor me të gjitha anët negative që ka, si: shthurja morale, kamata, padrejtësitë dhe mëkatet tjera.

Ai, e ngriti zërin edhe kundër thirrësve në imitim të verbët dhe ngrirje të mendimit të lirë, shenjtërimit të varezave, hyjnizimit të evlijave, përhapjes së bestytive në besim, bidateve në adhurim dhe devijimeve në sjellje.

Ai e ngriti zërin kundër pushtetarëve tiranë dhe plangprishës, si dhe i thirri të gjithë të bashkohen për ngritjen e shtetit islam, i cili nuk don mendimadhësi dhe trazira në tokë.

Edhe Sejjid Kutubi e ka ngritur zërin kundër të gjitha formave të xhahilijetit: doktrinar, ideor, dhe xhahilijetit në sjellje. Ai e ngriti zërin kundër laicizmit i cili bëri agresion mbu umetin islam, kundër sionizmit që ua rrëmbeu muslimanëve tokat, kundër kryqzatave që i shpallën armiqësi këtij umeti dhe kundër diktatorëve tiranë. Lapsi i tij i shkathtë qe shpata që e ngriti lartë Sejjid Kutubi në këtë betejë të ashpër. Në këtë betejë ai ra dëshmorë për thirrjen në të cilën besoi, dhe në rrugën e kësaj thirrje, e sakrifikoi më të shtrejtën që e sakrifikon njeriu. Ai kishte mundësi ta zbusë qëndrimin e vet dhe të pajtohet me tiranët, por ai qëndroi i fortë si bleshkët e larta, bëri durim si hero i vërtetë, dhe e takoi Allahun i këqaur me atë që ka bërë. Kur them se ai është shehid, këtë e them nga shkaku se ai është vlarë me pa të drejtë, për atë pse e mbronte fenë dhe thirrjen islame, e nuk u vra se kishte vlarë dikë tjetër, dhe as se kishte bërë zina pasi të ketë qenë i martuar, dhe as se ka dalë prej feje. Ai u vra se e tha të vërtetën para pushtetarit tiran. Në hadith qëndron: "Zotëriu i shehidave është Hamza, dhe një person që i drejtohet një pushtetari tiran, e urdhëron në të mirë dhe e ndalon nga e keqja, dhe ai e vret". ¹⁷

Ndoshta Sejjid Kutubi ka qenë më i ashpër se sa duhet në qëndrimin e tij ndaj xhahilijetit dhe në përshkrimin e disa shoqërive bashkëkohore islame, ndoshta edhe ka gabuar në disa pikëpamje dhe qëndrime të tij, në të menduarit apo në mënyrën e shprehjes, ngase për asnjë njeri nuk

¹⁶ El-En'am: 152.

¹⁷ Hadithin e ka shënuar Hakimi, vëll.III, f.195, dhe këtë hadith e ka klasifikuar sahih-autentik. Me këtë është pajtuar edhe Dhehebiju. Hadithi është transmetuar prej Xhabirit.

pretendohet se është i pagabueshëm, dhe as vetë Sejjid Kutubi nuk ka pretenduar për veten se është i pagabueshëm. Çdo njërit i merret dhe i lehet fjala, çdo mendimtar ndikohet nga koha, vendi dhe rrethanat në të cilat jeton. Sejjid Kutubi ka shkruar në kohën kur ka vuajtur dënime të rënda në burgjet e Naserit në Egjipt, në ndërkohë që i ka parë se si komunistët dhe bashkëmendimtarët e tyre dirigjojnë me mediat dhe institucionet e kulturës. Mirëpo, kjo që e thamë, nuk e ul vlerën dhe peshën e Sejjid Kutubit, nuk e bën atë të parëndësishëm dhe nuk ia njollos autoritetin, ngase ky njeri, me konsensusin e atyre që e duan dhe që nuk e duan, është një autoritet i kalibrit të lartë në analet e thirrjes islame në kohën tonë, pa marrë parasyshë e pajtohet apo nuk pajtohet dikush me këtë. Asnjë nuk dyshon në sinqeritetin dhe përkushtimin e Sejjid Kutubit. Për këtë, fjalët e tij zunë vend në zemra dhe u pranuan me eufori, sikur që pranohet me eufori edhe uji i ftohtë dhe i këndshëm nga njeriu i etshëm.

Unë kam dhënë kritika për disa gjëra që ka shkruar prof. Sejjid Kutubi, dhe kam debatuar për këto gjëra në mënyrë akademike, pa mos e nënçmuar dhe pa mos e përbuzur pozitën e tij, si dhe pa mos e mohuar dashurinë ndaj tij, ngase dallimi në mendime, nuk mund ta prish dashurinë e ndërsjellë. Këto kritika i kam drejtuar për disa qëndrime të prezantuara në librin e tij El-Islam ve mushkilatu-l-hadare (Islami dhe problemet e civilizimit).

Unë edhe pse e dua Sejjid Kutubin, më pëlqen mënyra e qasjes së tij, dhe e çmoj mendjemprehtësinë dhe sinqeritetin e tij, nuk e shejtëroj. Po unë nuk e shejtëror as Meududin, as Hasan el-Benën dhe asnjë reformator tjetër të madh. Unë e marr prej tyre më të mirën, ndërkaq e lë atë që mendoj se nuk ia kanë qëlluar, e ajo është pak në krahasim me trashigiminë e tyre të madhe që e kanë lënë. Dijetarit i mjafton që pjesa më e madhe e mendimeve të tij (e jë të gjitha B.A) të jenë të sakta, gjë që, falë Allahut, është evidente te këta njerëz. Prej mirësive të shkëlqyeshme të kësaj feje me të cilën na nderoi Allahu është se dijetari i cili jep mund shkencor, nuk privohet nga shpërblimi, edhe nëse nuk ia qëllon në përfundimet dhe qëndrimet e veta. Ndërkaq, ata të cilët i mohojnë dijetarët e shquar, për atë se kanë bërë disa gabime, nuk janë të objektiv dhe nuk gjykojnë drejtë. Kjo, ngase të tillët, kërkojnë shejtëri nga ata të cilët nuk janë të shejtë? A thua ka ndonjë at që ndonjiherë nuk ka ra?! A thua ka ndonji shpatë që ndonjiherë nuk është ndalur?! Dhe a thua ka ndonji dijetar që ndonjiherë nuk gabon?" Muadh ibn Xhebeli ka thënë: "Kij kujdes ndaj rrëshqitjeve të njeriut të urtë, por kjo, le mos të largoj prej tij. Ai ndoshta do të përmirësohet". Transmetimin e ka shënuar Ebu Davudi në Sunen.

VENDIMI I GJYKATËS NË GJERMANI

Pjestari i grupimit El-Ahbash, në vërejtjen e tij të katërt ndaj meje, ka thënë: "Ky, në një pyetje që iu parashtrua, u përgjigj se vendimi i një gjykate në Gjermani, për ndarjen e gruas nga burri musliman, është valid. Kjo fetva është e pabazë me konsensus-ixhma".

Ky pjestar i ngratë i grupimit El-Ahbash, në çdo çështje, pretendon se ka konsensus-ixhma, e ai nuk e di se ç'do të thotë konsensusi-Ixhmaja. Ai i ka bastarduar dhe shtrembëruar fjalët e mia për çështjen në fjalë. Kjo, ngase në Akademinë Europiane për Fetva dhe Gjurmime, kërkojmë prej muslimanëve që t'i vërtetojnë aktet e kurorëzimit fetar- të cilat bëhen nëpër xhami apo nëpër qendra islame- në organet zyrtare shtetërore, me qëllim që mos nëpërkëmben e të drejtat e ndonjërës palë në rast të kontestit dhe mohimit të këtij akti. Kështu, nëse themi, fjala vjen, që një burr e dëmton gruan e vet, apo e sanksionon, apo nuk e mirëmba materialisht, apo ik prej saj, dhe ajo nuk e di ku gjindet, e xhamia apo qendra islame nuk mund ta zgjidh problemin e tyre, atëherë nuk ka zgjidhje tjetër pos që gruaja t'i drejtohet gjykatës në vendin përkatës dhe ata t'i nënshtrohen ligjit dhe rendit të vendit përkatës. Në këtë rast, nëse gjyqësori bie vendim që gruaja të shkurorëzohet prej burrit, me qëllim që të evitohet dëmi i cili i bëhet asaj, ky vendim është i saktë.

Ndërkaq, për sa i përket asaj se jomuslimani nuk ka autoritet mbi muslimanin, kjo vlen në vendet islame, ndërkaq jashta vendeve islame, kjo gjë nuk mund të zbatohet nga muslimani, e Allahu nuk e randon një njeri përtej mundësive të veta. Shiqur realisht, ky autoritet i

jomuslimanit mbi muslimanin, në rrethanat përkatëse, gjindet në shumë gjëra, ndërkaq muslimani nuk ka zgjidhje tjetër, pos që ta pranon, bazuar në atë se gjindet në vendin e popullit jomusliman dhe është i obliguar t'i përmbahet ligjit dhe rendit në këtë vend, pa marrë parasyshtë a ka shtetësi të këtij vendi, apo vetëmleje qëndrimi.

HAKU I MËSUESIT DHE HAKU I PRINDIT

Pjestari i grupimit El-Ahbash, në vërejtjet e tij ndaj meje, në mes tjerash ka thënë: "Në një rast tjetër, ka pretenduar se e haku i mësuesit ndaj nxënësit, është më i madh se haku i prindërve të atij nxënësi. Edhe ky konstatim është i pa bazë".

Vërtet, kjo është prej shpifjeve dhe gënjeshtreve që ata njerëz pa fije përgjegjësie dhe ndërgjegje ia lejojnë vetes t'ua ngjesin dijetarëve të umetit. Abdullah ibn Omeri r.a. ka transmetuar prej të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. se ka thënë: "Te cili person gjinden katër cilësi, ai është munafik i vërtetë, e te cili person gjindet ndonjë nga ato cilësi, te ai gjindet një cilësu nifaku-hipokrizie, dhe këtë e ka derisa ta len. Këto cilësi janë: Kur i besohet diçka, tradhton; kur flet, rren; kur premtion mashtron; dhe kur konfrontohet, i tejkalon kufijtë".¹⁸

Ligjëratat e mia audio dhe të shkruara, dhe librat e mia, e konfirmojnë atë që e ka konfirmuar Kur'ani, gjegjësisht faktojnë se haku ndaj prindërve renditet pas hakut ndaj Allahut të Madhërishëm, dhe se respektimi i tyre, vin pas njëshmërisë së Allahut-Teuhidit. Kjo shihet qartë në suren En-Nisaë, suren El-Israë, suren Lukman dhe në sure tjera të Kur'anit. Për atë, ky shpifës, prej ku e ka sjellur këtë akuzë të madhe? Nëse është i singertë, le ta tregojë saktë ku gjindet në librat e mia apo në ligjëratat e mia të inçizuarat? Ndoshta ky njeri, këtë gjë e ka marrur nga ajo që e kam thënë një edicion të emisionit "El-Munteda" në kanalën e Abu Dabit, ku duke folur për edukimin kam përmendur se për vlerën e mësuesit është rrëfyer se një njeri i madh e ka respektuar mësuesin më tepër se babain. E kanë pyetur për këtë gjë, e ai ka thënë: "Babai është shkak i jetës time që mbaron (ka për qëllim jetën e trupit), ndërkaq mësuesi është shkak i jetës time të pambarim (ka për qëllim jetën e shpirtit)". Një poet, këtë përkufizim e ka shprehur përmes vargjeve poetike si vijon:

Ky është edukatori i shpirtit tim, e shpirti është esenca,
E ai është edukatori i trupit tim, e trupi është aksidental.

Unë, ndaj këtyre fjalëve, kam komentuar si vijon: Disa prindër nuk mjaftojnë vetëm me rritjen dhe përkudjesin material ndaj fëmijëve të vet, por janë të përkushtuar edhe ndaj edukimit mendor dhe shpirtëror të tyre, me qëllim që të bëhen muslimanë të vërtetë.¹⁹ Përmendja e fjalëve të personit për hakun e mësuesit, nuk do të thotë se haku i mësuesit në përgjithësi është më i madh se haku i prindërve.

LAVDËRIMI I SHEJH ALBANIT

Pjestari i grupimit El-Ahbash, duke i sqaruar çështjet në të cilat unë e kam kundërshtuar sheriatin e pastër, dhe për të cilat çështje ai kërkon dule me mua, Allahu e udhëzoftë, ka thënë: "Në librat e veta, e lavdëron Nasirudin Albanin dhe e quan muhadith të madh, ndërkaq Albani është i devijuari më i madh në këtë kohë, i cili ka mendime që i kundërshton gjithë tjerët. Albani ka kërkuar prej shtetit saudian që ta nxjerr varrin e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. dhe dy shokëve të tij, prej xhamisë së Pejgamberit s.a.v.s. Ai ka dhënë fetva se banorët e Bregut Perëndimor në Palestinë, janë jobesimtarë dhe mëkatarë, ngase nuk janë larguar prej aty, sikur që është larguar i Dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe sahabet prej Meke në Medinë".

¹⁸ Hadithin e kanë shënuar Buhariu dhe Muslimi. Shih: *El-Lu'lu'u ve-l-merxhan*, nr.37.

¹⁹ Shih: Emisionin "Edukimi në Islam", me datë 18/09/1999.

Islami na ka mësuar që të jemi të drejtë dhe të dëshmojmë me drejtësi për hirë të Allahut, bile edhe nëse ajo dëshmi është kundër nesh, kundër prindërve dhe të afërmeve tanë, si dhe rrejtja ndaj një populli, mos të na shtyjë që mos të jemi të drejtë ndaj tyre. Allahu i Madhërishëm ka thënë: <<O ju që besuat, vazhdimisht të jeni dëshmuar të drejtë për hirë të Allahut edhe nëse është kundër (interesit) vetvetes suaj, kundër prindërve ose kundër të afërmeve...>>²⁰; <<O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hirë të Allahut, duke dëshmuar të drejtën, dhe të mos u shtyjë urrejtja ndaj një populli e t'i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë. Kinie dro Allahun...>>.²¹ Besimtari i vërtetë, kur të jetë i kënaqur me diçka, kjo nuk e bën që të jetë i padrejtë, dhe kur të hidhërohet, hidhërimi nuk e bën që të largohet prej të vërtetës. Ai kur dëshmon, dëshmon në bazë të asaj që e di, dhe në rrugën e Allahut, nuk ka frikë prej kritikave dhe qortimeve të njerëzve.

Unë dëshmoj se shejh Albani, pa dyshim, është muhadith i madh, për të cilën gjë flasin veprat e tij të shumta në fushën e hadithit. Ai ka bërë redaktim të shumë veprave në fushën e sunetit, ka bërë klasifikim dhe ndarje të haditheve autentike dhe haditheve të dobëta. Ai ka vepra të shkëlqyera në këtë fushë, fjala vjen, verifikimi i librit “Mishkatu-l-mesabih”, “Muhtesaru Sahihi Muslim” e imam Mundhirijut, “Es-Sunne” e Ibn Ebi Asimit, etj. Poashtu, ai është autor i librave “Silsiletu-l-ehadith es-sahiha”, “Silsiletu-l-ehadith ed-daife”, “Irvau-l-galil fi tehrixhi ehadithi Menari-s-sebil”, “Sahihu Ebi Davud”, “Sahihu et-Tirmidhij”, “Sahihu en-Nesaj”, “Sahihu Ibn Maxhe”, “Sahihu-l-Xhami’i-s-sagir ve zijadatihi”, etj., edhe pse unë nuk pajtohem me të në saktësimin e disa haditheve për shkak të rrugëve të shumta të transmetimit, dhe mos marrja parasysh e teksteve dhe përmbajtjes së haditheve, në disa raste. Mirëpo, krahas kësaj, unë nuk pajtohem me shejh Albanin në shumë mendime të tij në çështjet juridike islame dhe ia demantoj mendimet, në veçanti kur ka mendime që dijetarët tjerë nuk i mbështesin, si dhe në mendimet që ndërtohen mbi akceptim literarist i teksteve fetare. Nisur nga kjo, unë nuk jam pajtuar me shejh Albanin në ndalimin e arit për femrat, nëse është në formë të rrethit; nuk jam pajtuar me të në mosobligimin e zekatit për mallrat e tregtisë. Unë gjërisht kam dhënë vërejtje për mendimet e tij në librin tim “El-Merxhi’ijjetu-l-ulja fi-l-Islam li-l-Kur’an ve es-Sunneti”. Poashtu, unë e kam demantuar fetvanë e tij për obligimin e shpërnguljes së banorëve të Bregut Perëndimor dhe Gazës prej Dar-l-Harb (Vendit të luftës) apo Daru-l-Kufër (Vendit të mosbesimit), në Daru-l-Islam (Vendin Islam), ngase me këtë i bëhet shërbimi më i madh i mundshëm Izraelit, gjegjësisht thirret që të shprazen vendet nga banorët autoktonë. Unë, këtë demant, e kam bërë gojarisht, ngase fetvaja e shejh Albanit ka qenë gojarisht, dhe shejhu këtë fetva nuk e ka shkruar.

Për sa i përket asaj se shejh Albani ka kërkuar prej qeverisë së Saudisë që ta nxjerr prej xhamie varrin e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. dhe të dy shokëve të tij, unë këtë gjë nuk e kam dëgjuar. E nëse është e saktë, unë e refuzoj një qëndrim të tillë. Nëse është e saktë, si mund ta thotë këtë, kur kjo është në kundërshtim me atë që e kanë konfirmuar sahabet, tabi’inët dhe tebei tabi’inët, si dhe të gjitha gjeneratat e umetit deri në ditët tona? A ka mundësi që gjithë umeti islam të bashkohet në diçka që është gabim?

PULA E NGULFATUR

Pjestari i grupimit El-Ahbash, duke i sqaruar çështjet në të cilat unë e kam kundërshtuar sheriatin e pastër, dhe për të cilat çështje ai kërkon dule me mua, Allahu e udhëzoftë, ka thënë: “Ky njeri, mendon se pula e ngulfatur lejohet të hahet, gjë që bie ndesh qartë me ajetin fisnik”.

Kjo është falsifikim i fjalëve, ngase ky pjestar i grupimit El-Ahbash, këtu aludon në fjalët e Ibn El-Arebijut përkitazi me ngrënien e kafshëve të therrura nga ana e ithtarëve të librit, në veçanti nga ana e krishterëve. Unë, me këtë rast, e kam përmendur mendimin e pjesës dërmuese të

²⁰ En-Nisaë: 135.

²¹ El-Maide: 8.

dijetarëve-xhumhurit, si dhe mendimin e Ibn El-Arebijut dhe bashkëmendimtarëve të tij të shkollës juridike Malikite. Kontesti mes palëve përqëndrohet në atë se a është kusht që edhe therrja e tyre sikur therrja e jonë, apo mjafton që të plotësohet ajo që ata e konsiderojnë therrje për ta lejuar ngrënien e mishit të kafshës sipas tyre? Është e njohur se ata nuk e hanë coftinën, siç veprojnë zjarrputistët.

Pjesa dërrmuese e dijetarëve e mbështesin opcionin e parë, ndërkaq Ibn El-Arebiju dhe bashkëmendimtarët e tij e mbështesin opcionin e dytë. Ibn El-Arebiju e specifikon ajetin që ka të bëjë me ndalimin e ngrënies së kafshës së furme dhe llojeve tjera që janë renditur pas saj, me njerëzit tjerë pos ithtarëve të librit, si dhe kafshët tjera të cilat nuk janë therrur. Dijetarët pohojnë se nuk ka kundërshtim në mes asaj që është e përgjithshme dhe asaj që është specifike. Në dritë të kësaj është dhënë fetvaja e njohur nga imam Muhamed Abduhu, e cila është përmendur në tefsirin El-Menar, gjatë komentit të ajetit të pestë të sures El-Maide.

Ne kemi parë se disa dijetarë të gjeneratave të para-selefit, e lejojnë ngrënien e kafshëve të therrura nga ithtarët e librit, e dihet se ata nuk e përmendin emrin e Allahut, bile e kanë lejuar ngrënien e kafshës gjatë therrjes së të cilës është përmendur emri i dikuj tjetër pos Allahut nga ana e ithtarëve të librit, ngase ata e kanë konsideruar ajetin: <<...**edhe ushqimet (të therrurat) e ithtarëve të librit janë të lejuara (hallall) për ju...**>>²², specifikues apo sqarues të ajeteve tjera. Abdurrezaku ka transmetuar në Musannefin e tij prej Aliut dhe Ibn Abasit se janë pyetur: "Ithtarët e librit, kur i therrin kafshët, përmendin emër tjetër, e jo të Allahut?" Ata dy janë përgjigjur: "Allahu kur e ka lejuar ngrënien e kafshës që e therrin ata, e ka ditur çka përmendin me rastin e therrjes së kafshës". Fjalë të këtilla janë transmetuar edhe prej Ataut.

Është transmetuar prej Ibn Mes'udit se ka thënë: "Ju keni shkuar në një vend ku muslimanët nuk therrin kafshë, ngase atje ka Nebatej dhe Persian. Për atë, kur të bleni mish, pyesni kush e ka therrur. Nëse atë kafshë e ka therrur hebreji apo krishteri, atëherë hanie, ngase ushqimi i tyre është i lejuar për ju".

Katade ka thënë: "Nëse të jep ushqim një hebrej, urdhëroje që han prej tij. Nëse ai e han, haje edhe ti, e nëse ai nuk e han, mos e ha edhe ti". Me këtë është për qëllim që muslimani të jetë i qetë se ai ushqim është i lejuar për hebrejin në fenë e tij. Së këtejmi, Katade ka thënë: "Nëse kafsha e therrur refuzohet nga ai, mos e ha edhe ti".²³ A thua ata dijetarë të shquar e kanë kundërshtuar Kur'anin kur thotë: <<**Dhe mos hani nga ajo që (para therrjes së saj) nuk është përmendur emri i Allahut...**>>²⁴; <<...**ajo që therrret jo në emrin e Allahut...**>>²⁵; apo ata këto ajete i kanë konsideruara të specifikuar me ajetin: <<...**edhe ushqimet (të therrurat) e ithtarëve të librit janë të lejuara (hallall) për ju...**>>²⁶

Poashtu, më duhet të theksoj se unë nuk kam thënë se mendimi i Ibn El-Arebijut është i saktë, apo është më i saktë se mendimet tjera, por, unë thjesht e kam përmendur si mendim, ngase ndonji musliman, i cili nuk gjen ushqim tjetër, pos kafshëve të therrura të ithtarëve të librit, si rezultat i asaj se jeton në ndonji vend të largët ku nuk ka musliman, apo për shkaqe të ngjashme, mund të ketë nevojë për këtë mendim. Poashtu, më duhet të përmendi se ky libër është shkruar për masat e gjëra, e jo për elitat, e ai që shkruan për masat e gjëra duhet ta mbështesë lehtësimin e jo randimin, ngase kështu na ka porositur i Dërguari i Allahut s.a.v.s.: "Lehtësoni e mos vështirësoni, përgëzoni e mos largoni".²⁷ Kjo më ka shtyrë që kur të hasi dy mendime të barabarta apo të afërta, ta mbështesë më të lehtin e jo më të sigurtin, me qëllim që t'ua lehtësojë njerëzve të dobët dhe t'ua bëjë fenë të dashur. Ka qenë praktikë e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. që kur është dashur të zgjedhë ndërmjet dy çështjeve, e ka zgjedhur më të lehtë nëse nuk ka qenë mëkat.

²² El-Maide: 5.

²³ Shih: Abdurrezak, *El-Musannef*, vëll.VI, f.117-112, transmetimet nr.10176-10190.

²⁴ El-En'am: 121.

²⁵ El-Maide: 3.

²⁶ El-Maide: 5.

²⁷ Hadithin e kanë shënuar Buhariu dhe Muslimi. Shih: *El-Luë'lu'u ve-l-merxhan*, nr.1131. Hadithi i përcjellur prej Enesit.

Falë Allahut, librin Hallalli dhe Harami (El-Halalu ve-l-Haram), është shkruar me rekomandim prej udhëheqësisë së Az-harit në kohën e imam dhe fekihut të njohur shejh Mahmud Sheltut dhe nën patronazhin e Drejtorisë së Përgjithshme për Kulturën Islame në kohën kur kjo drejtori drejtohej nga profesori i madh Muhamed el-Behij, i cili libër më pas u përkthye në anglisht dhe në gjuhë tjera. Drejtorja e Kulturës Islame në Az'har këtë libër ia dha një recenzenti, i cili e miratoi dhe dha komplimente, dhe këtë libër e miratoi edhe udhëheqësia e Az'harit.

Ky libër u përhap në mënyrë të paparashikueshme në botën arabe dhe islame, si dhe shumë dijetarë autoritativë dhanë komplimente për këtë libër, bile dijetari i shquar Mustafa Ez-Zerka ka thënë: "Është obligim për çdo familje muslimane që ta ketë këtë libër". Profesor Muhamed el-Mubarek, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: "Ky është libri më i mirë në këtë temë". Profesori i madh, Ali Tantavi, ua ka mësuar nxënësve të vet këtë libër në fakultetin e pedagogjisë së Meke Mukerreme. Hadithologu i njohur shejh Nasirudin El-Albani është përkujdesur për verifikimin e haditheve të këtij libri. Poashtu, në Pakistan, dijetari i shquar Ebu-l-A'ëla el-Meududi dha komplimente për këtë libër, në një letër drejtuar autorit enkas për këtë libër. Edhe departamentet akademike për studime islame në universitetet e Karaçit dhe Penxhabit i kanë kushtuar kujdes këtij libri.

Në fillim të viteve të gjashtëdhjeta, Xhemile Sheuket (që më pas do ta merr titullin Dr), paraqiti një studim në departamentin e studimeve islame në Universitetin e Penxhabit në lidhje me këtë libër si një model i ri në shkrimin e të drejtës islame. Ajo me këtë studim e arriti titullin magjistër, ndërkaq mentor e ka patur dijetarin e shquar Alauddin Es-Siddiki, i cili më pas ka qenë edhe rektor i këtij universiteti. Edhe një student tjetër në universitetin e Karaçit, ka paraqitur një studim tjetër për këtë libër.

Libri Hallalli dhe Harami (El-Halalu ve-l-Haramu) ka patur mbi 40 botime në gjuhën arabe, dhe është botuar nga disa shtëpi botuese në Kajro, Bejrut, Kuvajt, Algjeri, Marok dhe Amerikë. Kjo ka të bëjë me botimet e autorizuara, e mos të flasim më për botimet e pa autorizuara, të cilat nuk mund të ndiqen.

Ky libër është përkthyer në anglisht, frengjisht, gjermanisht, spanjolisht, italisht, urdu, persisht, turqisht, malajzisht, indonezish, kinezisht, shqip, disa gjuhë të Indisë, etj.

KAMATA MË E RËNDË SE ZINAJA

Pjestari i grupimit El-Ahbash, duke i sqaruar çështjet në të cilat unë e kam kundërshtuar sheriatin e pastër, dhe për të cilat çështje ai kërkon dule me mua, Allahu e udhëzofte, ka thënë: "Ky njeri thotë: "Nji dirhem i kamatës, të cilin njeriu e han me vetëdije, është më i keq se 36 kurvëri". Këto fjalë janë në kundërshtim me argumentet tradicionale, racionale dhe me konsensusin, edhe pse ai është mbështetur në një hadith jo të saktë, ndërkaq i njeiti vetë është besatuar se do të merr për argumente vetëm hadithe të sakta".

Këto fjalë të këtij pjestari të grupimit El-Ahbash dëshmojnë për një injorancë të rëndë dhe për gënjeshtëri edhe më të rëndë, dhe vërtet nuk e di, këta njerëz si marrin guxim që veten t'ia atribuojnë dijes dhe dijetarëve, kur dija nuk ka kurgjë të përbashkët me ta. Këtë konstatim do ta mbështes në argumente:

1. Personi në fjalë ka pretenduar se unë them që "nji dirhem i kamatës, të cilin njeriu e han me vetëdije, është më i keq se 36 kurvëri", ndërkaq unë këtë nuk e kam thënë, por këto janë fjalë të një hadithi të cilin e kanë shënuar dijetarët e hadithit në koleksionet e tyre, dhe disa hadithologë e kanë konfirmuar saktësinë e këtij hadithi. Për këtë shkak, unë e kam përmendur këtë hadith në librin tim Hallalli dhe Harami (El-Halalu ve-l-Haramu), si argument për atë se kamata është mëkat i madh te Allahu i Madhërishëm.

Kështu, Imam Ahmedi ka transmetuar në Musned-in e tij, vëll.V, f.225, prej Abdullah ibn Handhales, njeriut të cilit ia kanë larë xhenazen melekët, se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka

thënë: "Nji dirhem i kamatës, të cilin njeriu e han me vetëdije, është më i keq se 36 kurvëri".

Zinxhiri i transmetuesve të këtij hadithi në Musned është si vijon: "Na ka rrëfyer Husejn ibn Muhamed, (ka thënë) na ka rrëfyer Xheriri-ka për qëllim Ibn Hazimin- prej Ejjubit e ky prej Ibn Ebi Mulejkes e ky prej Abdullah ibn Handhales". Albani ka thënë: "Ky është zinxhir i saktë transmetuesish konform kushteve të Buhariut dhe Muslimit. Ata të cilët kanë thënë se e metë e këtij zinxhiri transmetuesish është Xheriri i cili ka ndryshuar në memorje para vdekjes, nuk ia ka qëlluar, ngase kur i është përzier memorja, askush nuk ka dëgjuar nga Xheriri. Këtë e ka thënë Ibn Mehdiju. Këtë hadith e ka transmetuar edhe Darekutniju me këtë zinxhir transmetuesish-sened.

Këtë transmetim e kanë transmetuar edhe Ahmedi edhe Darekutniju prej Abdullah ibn Handhales e ky prej Ka'ëbit, si thënie të tij. Darekutniju ka thënë: "Ky transmetim si fjalë sahabiju është më i saktë se sa i hadith i Pejgamberit s.a.v.s." Shihe hadithin nr. 49 të librit El-Bideu min es-Sunen ed-Darekutnij, vëll.III, f.16, redaktuar nga Hashim Abdullah el-Jemani. Dijetarët kanë thënë: Thënia e sahabijut në këtë rast, ka tretmanin e hadithit të atribuar të Dërguarit të Allahut s.a.v.s., ngase përcaktimi me numër të caktuar, nuk mund të bëhet sipas vlerësimit personal të njeriut.

Këtë hadith e ka përmendur imam Mundhiriju në librin e tij Et-Tergib ve et-terhib dhe ka thënë: "Këtë hadith e kanë transmetuar Ahmedi dhe Taberaniju në El-Muëxhemu-l-kebir, dhe transmetuesit e versionit të Ahmedit janë të vërtetë. Shihe hadithin nr.1060 në librin tonë El-Munteka min et-tergibi ve et-terhib".

Këtë hadith e ka shënuar edhe hafidh Nuruddin el-Hejthemij në librin Mexhmeu-z-zevaid dhe i ka thënë të njëjtat fjalë si Mundhiriju, vëll.IV, 117.

Dijetari i shquar el-Munavi ka përcjellur prej hafidh Irakijut se ka thënë: "Transmetuesit e këtij hadithi janë të besueshëm" (Fejdu-l-Kadir, vëll.III, f.524).

Është përcjellur prej Ibn El-Xheuzijut se ky e ka shënuar hadithin në hadithet e trilluara "El-Meuduat", dhe të metë të këtij hadithi e identifikoi transmetimin prej Husejn ibn Muhamedit. Është përcjellur prej Ibn Ebu Hatimit se ka thënë: "E kam parë, por nuk kam dëgjuar prej tij". Ibn Haxheri ka bërë vërejtje se: "Këtë transmetues e kanë marrur si argument edhe Buhariu dhe Muslimi, e poashtu edhe hadithologë tjerë e kanë konsideruar të besueshëm. Ky hadith ka edhe hadithe tjerë që dëshmojnë për autenticitetin e tij" (Fejdu-l-Kadir, vëll.III, f.524).

Është e njohur se Ibn El-Xheuzij disa herë është zgjeruar në gjykimin e hadithit si të trilluar.

Në kohën tonë, këtë hadith e ka konsideruar autentik shejh Albani në librin Silsiletu-l-ehadith es-sahiha, nr.1033, si dhe në verifikimin e haditheve të librit tonë Hallalli dhe Harami (El-Halalu ve-l-Haramu), për çka shkroi libër me emrin Gajetu-l-merami. Ky hadith mban numrin 272 në këtë libër. Poashtu, këtë hadith e ka klasifikuar autentik edhe në librin Sahihu-l-Xhami'is-sagir ve zijadatihu, nr.3375.

Unë shumë herë nuk pajtohem me shejh Albanin, në veçanti në qëndrimet e tij në lidhje me çështjet juridike kur dallon dhe ndahet nga dijetarët tjerë, por, megjithatë, unë nuk e mohoj, dhe asnji njeri objektiv nuk e mohon se shejh Albani është prej dijetarëve të mëdhej të hadithit, edhe pse unë kam disa vërejtje përkitazi me disa klasifikime të haditheve si autentike. Ka edhe dijetarë të hadithit që e kanë kritikuar, por, kjo nuk do ka ndonji problem, dhe kjo nuk e ul vlerën e tij.

Nisur nga kjo, ne bindemi në injorancën e thellë të këtij pjestari të grupimit El-Ahbash, i cili ka thënë se unë kam thënë kështu për kamatën, ndërkaq këto fjalë, nuk janë fjalë të mia, por janë hadith që i atribuohet të Dërguarit të Allahut, apo transmetim sahabiju.

2. Ky pjestar i ngratë i grupimit El-Ahbash, pretendoi se këto fjalë janë në kundërshtim me argumentet tradicionale, racionale dhe me konsensusin! E unë nuk e di, si ka pretenduar

ky njeri se këto fjalë janë në kundërshtim me argumentet tradicionale? Cilat janë ato argumente tradicionale të cilat i kundërshton kjo thënie? Cilin ajet të Kur'anit, cilin hadith pejgamberik, apo fjalën e cilit sahabij, tabi'ij apo cilit dijetar të madh e kundërshton kjo thënie?

Ne e pamë se këtë hadith e kishte transmetuar imam Ahmedi në Musned, Taberaniju në el-Muëxhemu-l-kebir dhe el-Muëxhemu-l-euset, Darekutniju në Sunen dhe Ibn Asakiri në Et-Tarih. Poashtu, këtë hadith e kanë pëlqyer edhe dijetarët më të vonshëm të hadithit si: Mundhiriju, Irakiju, Hejthemiju, Ibn Haxheri, Sujutiju dhe El-Munavi. Për një rast të këtillë, nuk thuhet se është në kundërshtim me argumentet tradicionale.

Ndërkaq, për sa i përket pretendimit të këtij personi se këto fjalë janë në kundërshtim me arsyen, oh Zot oh Zot, a e di ky njeri domethënien e kundërshtimit të arsyes? Ta kundërshtosh arsyen d.m.th. që besimi i një gjëje të tillë, ka për pasojë diçka absurde logjikisht. Fjala vjen, të vërtetosh dy gjëra kontradiktore. E në këtë rast, ku e sheh ai se është kundërshtuar arsyeja?

Nëse me arsye, aludohet në arsyen e muslimanit, atëherë duhet theksuar se muslimani e njih fenë e vet, e kupton se me çka e ka urdhëruar Allahu dhe i Dërguari i Tij, për atë edhe nuk ka pse mos e pranoj këtë hadith, ngase ky hadith është në frymën e Kur'anit i cili e ka zmadhuar mëkatën e kamatës më tepër se çdo mëkat tjetër, ashtu që Kur'ani e ka cilësuar kamatën, në atë mënyrë që nuk i ka cilësuar mëkatet tjera të mëdha. Allahu i Madhërishëm ka thënë: <<**O ju që besuat, kinie frikë Allahun dhe nëse jeni besimtarë të singert, hiqni dorë prej asaj që ka mbetur nga kamata (278) E në qoftë se nuk e bëni këtë (nuk hiqni dorë nga kamata), atëherë binduni se jeni në konflikt me Allahun dhe të Dërguarin e Tij...>>.28**

Kamata është më e keqe se zinaja, ngase për zina të shtyen instinkti shtazarak dhe epshi i këndellur, ndërkaq shkak që të shtynë në kamatë është lakmia djallëzore për ngrënien e pasurisë së njerëzve me pa të drejtë dhe shtrydhja e fukarave për llogari të të pasurve. Së këtejmi, i Dërguari i Allahut s.a.v.s. e ka radhitur kamatën në shtatë mëkatet e mëdha shkatërruese-el mubikat, ndërkaq nuk e ka radhitur zinanë në këto shtatë, edhe pse të dyja janë mëkate të mëdha. Nëse e lexon atë që e ka përcjellur El-Munavi prej Tibbijut, dhe atë që e ka thënë El-Harani, do ta kuptosh rrezikun e kamatës. Këto fjalë vërtetohen edhe nga ajo që e kanë thënë ekonomistët në kohën tonë për kamatën, gjegjësisht ata kanë pohuar se kamata është me rrezikshmëri të madhe për ekonominë, politikën, shoqërinë, vlerat dhe moralin, si dhe për paqen botërore.

Po edhe më e habitshme se e gjithë kjo, është pretendimi i pjestarit të grupimit El-Ahbash se ky hadith, apo përmbajtja e këtij hadithi, është në kundërshtim me konsensusin-ixhmanë.

Si duket, ky i ngratë, nuk di gjëfare për konsensusin, as për domethënien e konsensusit, e as për dispozitën e tij. Konsensusi-Ixhmaja, me pak fjalë: Është pajtimi i të gjithë dijetarëve muxhtehidë të umetit, në një periudhë kohore, për një dispozitë fetare. E tash pyes: Cila është dispozita fetare të cilën e ka kundërshtuar ky hadith? Si e ka kundërshtuar? Bile, si ka kundërshtuar ky hadith qëndrimin e katër shkollave juridike, apo njëres nga shkollat juridike, e mos të flasim më për kundërshtimin e konsensusit! Këta njerëz, për fat të keq, flasin gjëra të cilat nuk i dinë, dhe thonë për Allahun dhe për njerëzit gjëra që nuk i dinë.

3. Kjo që e thonë ata shpifës, flet se ata nuk kanë çka të thonë, për këtë, mundohen të gjurmojnë gjëra të cilat nuk kanë kuptim. Ata, thjesht, duan vetëm të flasin diçka dhe të shkarravitin në letra, bile edhe me fjalë pa lidhje dhe pretendime të kota.

Lutja jonë e fundit është: I tërë falënderimi i plotë, singërisht i takon vetëm Allahut, Zot i botëve.

Prej arabishtes: Bashkim Aliu

²⁸ El-Bekare: 278-279.